

# STATUTI

I

## BANKES ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

### KAPITULLI 1

#### FORMA, EMERTIMI, KOHEZGJATJA DHE SELIA E BANKES.

##### **NENI 1 :      FORMA JURIDIKE**

Banka Arabe Shqiptare Islamike (BASHI) eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime (Sh.A.) ne perputhje me Ligjin Nr.8075 date 22.02.1996 "Per Sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise"dhe Ligjin Nr.7638 date 19.11.1996 "Per shoqerite tregtare".

Banka do te funksionoje ne perputhje me dispozitat e ligjeve te lartpermendura dhe dispozitave te ketij Statuti.

##### **NENI 2 :      EMERTIMI**

Emertimi i plote i bankes eshte : " Banka Arabe Shqiptare Islamike" Sh.A., dhe emertimi i shkurtuar eshte : B.A.SH.I.

Banka ka stemen dhe vulen e saj zyrtare.

##### **NENI 3 :      SELIA DHE RRJETI**

Selia qendrore e Bankes eshte ne Tirane, ku eshte vendosur dhe Drejtoria e e saj e Pergjithshme.

Banka mund te zgjeroje ose pakesoje rrjetin e saj (filiale, dege, agjensi ose zyra bankare) ne territorin e Republikes se Shqiperise , pa autorizimin paraprak te Bankes se Shqiperise.

Banka mund te hape filiale te saj, dege, agjensi ose zyra bankare jashte territorit te Republikes se Shqiperise, me miratimin paraprak te Bankes se Shqiperise.

##### **NENI 4 :      KOHEZGJATJA E BANKES**

Banka themelohet per nje periudhe kohe te pa caktuar.

# **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

## **KAPITULLI 2**

### **VEPRIMTARITE E BANKES**

#### **NENI 5 : OBJEKTET E BANKES**

- I :** Veprimtaria e Bankes, si nje banke e licensuar ne Shqiperi, eshte te kryeje aktivitet brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise per t'ju sherbyer shqiptareve dhe te tjereve.
  
- II :** Banka merr persiper ne qe ne kryerjen e aktivitetit te saj t'ju jete besnike parimeve te Shariatit Fisnik Islamik ne te gjithë transaksionet e saj financiare, veprimet dhe aktivitetet e tjera dhe do te emeruje Komitetin Fetar per keshillimin, aprovimin ose mosaprovimin, nepermjet ligjeve qe rregullojne mardheniet e Bankes.
  
- III :** Banka do te kryeje te gjitha format dhe tipet a aktiviteve bankare dhe investuese si dhe sherbime te tjera te lidhura me to ne gjithë sektoret : tregeti, industr, bujqesi, pasuri te patundshme, turizem, strehim dhe sektoret e tjere ne perputhje me rregullat e vete Bankes. Te perfshire ne keto objekte, por duke mos u kufizuar vetem ne to, jane dhe operacionet e meposhtme :

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

1. Hapja e te gjitha llojeve te llogarive dhe pranimi i depozitave dhe fondeve te tjera ne monedha te ndryshme, si ne rastin kur keto depozita jane per t'u ruajtur me autorizimin per t'u disponuar dhe me garancine e pageses te kerkuar, ose per qellime investimi me pjesmarje fitimi sic bihet dakord midis Bankes dhe klientit.
2. Menaxhimi i fondeve, ceqeve, arketimi i faturave tregtare, transferimi i fondeve, kryerja e aktiviteteve te L/C, L/G.
3. Kooperimi me institucionet financiare e bankare qe deshirojne te kryejne aktivitate biznesi.
4. Operacioni i kembimit te valutave te huaja dhe i aktiviteteve te tjera te sherbimit bankar.
5. Perdorimi dhe menaxhimi i fondeve per investim dhe financim brenda kufijve te likuiditeteve te kerkuara per cdo fond.
6. Menaxhimi i financimeve te sindikuara qofte individualisht qofte ne lidhje me pale te tjera.
7. Ofrimi i sherbimeve te menaxhimit te investimeve per individe, korporata dhe organizata publike e private per projekte investimi.
8. Blerja, shitja dhe zhvillimi i projekteve ekzistuese dhe ndermarrja e veprimeve te tjera ne sektore te ndryshem me qellim per hapjen e L/C-ve.
9. Blerja e pajisjeve, bimeve dhe cdo aktivi te perdorshem sic kerkohet prej atyre qe veprojne me Banken.

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

10. Te kryeje dhe te ndermarre biznesin e dhenies me qera te pajisjeve, te jape me qera ose me baze leje, ose mbi nje menyre tjeter si dhe te kryeje te gjitha llojet e operacioneve qe lidhen me te gjitha llojet e pajisjeve, pasurive dhe aktiveve qe perfshijne te gjitha llojet e mallrave, artikujve ose gjerave qe perfshijne automjete, anije, anije per transport udhetaresh, avione, aeroplane, makina fluturuse, pajisje zyresh, kompjutera, satelite dhe cdo pajisje kapitale, qofte e tundshme ose e patundshme.

Te bleje, te marre me qera, ose me leje, ose ne shkembim, te bleje me keste ose thjesht te bleje cdo pasuri te tundshme ose te patundshme, patente, license, te drejta ose privilegje te cilat Kompania mund t'i gjykoje te nevojshme ose te pershtatshme per ndonje biznes te Kompanise; te zhvilloje dhe te ktheje ne llogari dhe te trajtoje njelloj vecanerisht ndonje toke, ferme, ndertesa ne nje menyre te tille qe mund te gjykohet e pershtatshme si dhe te ndertoje, mirembaje dhe te nderroje ndonje pasuri te tundshme ose te patundshme te nevojshme ose te pershtatshme per qellimet e Kompanise; te paguaje per to ose ne te holla ose me aksione ose dhe me letra me vlere si dhe te shese, te jape me qera ose nen-qera ose perndryshe te disponoje ose te dhuroje ndonje pasuri te tundshme ose te patundshme qe i perket Kompanise por qe nuk i duhet per biznesin aktual te Kompanise.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

11. Te menaxhoje portofolet financiare ne aksione, pjesmarje si dhe ne aksione investuese qofte per llogari te Bankes ose te paleve te tjera.
12. Te investoje dhe te perdore likuiditetet cash qe Banka ka ne dispozicion, me forma dhe metoda te pershtatshme, te gjykuara si te tilla nga Keshilli Drejtues.
13. Te hyje ne transaksionet e tregtimit te mallrave dhe te metaleve te tregtueshme.
14. Te perdore burimet natyrale dhe te bleje, te marre pjese dhe te tregetoje koncesionet dhe patentat.
15. Te ngreje dhe te marre pjese ne kompani dhe te zoteroje aksionet e tyre ose aksione pjesmarje si dhe te kryeje tregtimin e te gjitha llojeve te aksioneve te kompanive, objekti dhe aktiviteti i te cilave nuk bie ndesh me Ligjin e Bankes.
16. Te themeloje banka ose kompani investuese, te marre pjese ne to dhe ne drejtimin e tyre pasi te kete siguruar me pare aprovimin e Bankes se Shqiperise.
17. Te drejtoje biznesin e eksport importit te mallrave, materialeve, bimeve etj.
18. Te ngreje magazina per investim, per ti dhene me qera ose per perdorim dhe shfrytezim direkt.
19. Te ngreje, marre pjese, drejtoje ne truste kooperative per te siguruar fonde si dhe mbrojtje nga rreziqet e investimeve, pervec bashkepunimit me kompanite Islamike te sigurimit dhe te risigurimit ne nivel lokal ose nderkombetar.

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

20. Banka mund te marre pjese ne cdo forme me organizatat qe kryejne aktivitet biznesi te njejte ose te ngjashem me te ose qe mund ta ndihmojne ate ne realizimin e objektivave te saj, te shkrihet me to, t'i bleje ose t'i zoteroje ato.
21. Banka mund te kryeje ndonje ndermarrje si pjese e..., plotesuese e..., ose qe ka lidhje me ndonje nga objektivat e siperpermendur.
22. Te hyje ne mareveshje me ndonje Qeveri ose drejtori Qeveritare ose autoritet qe mund te jete udhezues per realizimin e objektivave kryesore te Kompanise, dhe te siguroje prej cdonjeres prej ketyre Qeverive, drejtorive qeveritare ose autoriteteve, ndonje te drejte, privilegj, license dhe koncesion te nevojshem dhe te deshirueshem me qellim qe te kryeje, te ushtroje, perdore ose te perputhet me keto mareveshje, te drejta, privilegje ose koncesione.
23. Te siguroje dhe te mbaje nje ose me shume pjesmarje ne tregun e kembimeve te aksioneve/letrave me vlere, shoqerive tregtare, ne tregun e kembimeve te mallrave, Clearing Houses te shoqerise ose ndryshe ne Shqiperi ose ne cdo vend te botes, te siguroje privilegjet e anetaresise si dhe te marre dhe te ruaje pjesmarjen ne ndonje shoqate ose bankiere, bankash tregtare, kompanish sigurimesh, brokers, veprimet e letrave me vlere ose te mallrave, ose ne cfaredo shoqate tjeter, anetaresia ne te cilat do te bente me te lehte punen e Kompanise persa i perket biznesit.

# BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

## KAPITULLI 3

### KAPITALI DHE AKSIONET

#### NENI 6 : KAPITALI

Kapitali i autorizuar i bankes do te jete njeqind milion USD i ndare ne nje milion aksione vlera e seciles eshte njeqind US Dollare. Kapitali i nenshkruar i Bankes do te jete njezet milion USD.

#### NENI 7 : AKSIONET E NENSHKRUARA NGA THEMELUESIT

Themeluesit te cilet kane firmosur Nenet e ketij Statuti kane nenshkruar per 200,000 (dyqindmije) aksione per nje vlere prej 20,000,000 (njezetmilion) USD. Banka Kombetare Tregtare Shqiptare do ta paguaje pjesen e saj ne *cash* me perjashtim te pjeses qe do te paguhet ne natyre. Aksionet e nenshkruara nga themeluesit jane shperndare si me poshte :

<u>Emri</u>	<u>Nr. i Aksioneve</u>	<u>Vlera nominale</u>
1. Banka Kombetare Tregtare	80,000	8,000,000
2. Banka Arabe Islamike (E.C)	40,000	4,000,000
3. Banka Islamike e Zhvillimit	30,000	3,000,000
4. Grupi Dallah Al-Baraka	20,000	2,000,000
5. Z. Hisham Ali Hafiz	2,000	200,000
6. Z. Hamed H. Mutabbagani	2,000	200,000
7. Z. Solaiman A. Elkhereiji	2,000	200,000
8. Z. Adnan H. Bogary	2,000	200,000
9. Z. Hayder Bin Laden	2,000	200,000
10. Busuness Focus SDN BHD (From 01.01.1997)	12,670	1,267,000
11. Znj. Amal H. Bogary	1,000	100,000
12. Brother Co.	5,000	500,000
13. Faisal Elkhereiji	1,330	133,000
<b>TOTAL</b>	<b>200,000</b>	<b>20,000,000</b>

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

1. Si promotore , Banka Arabe Islamike do te marre 0.5 perqind te vleres nominale te aksioneve prej te gjithë aksionereve dhe aksioneret duhet te paguajne ne Banke 1 % te vleres nominale te aksioneve si nje komision leshimi.
2. Banka Arabe Islamike dhe Aksioneret kane paguar aksionet e tyre dhe shuma eshte depozituar me Banken Arabe Islamike, Bahrein. Kjo shume do te mbetet ne banken e mesiperme ne emer te "Bankes Arabe Shqiptare Islamike" dhe nuk mund te terhiqet pervec se pasi Banka te jete regjistruar dhe te kete dale vendimi i Keshillit te pare Drejtues.

### **NENI 8 :**

1. Palet ne fjale bien dakord te ndermarrin hapat e nevojshem qe te sigurojne regjistrimin per themelimin e Bankes dhe te ndermarrin gjithë formalitetet e tjera te nevojshme qe te perfeksionojne inkorporimin e saj duke ia paraqitur keto Nene te Statutit si dhe Memorandumin, Bankes se Shqiperise, duke i dhene asaj te gjithë dokumentat te cilat mund t'i duhen dhe te kryeje regjistrimin e Bankes ne Regjistrin Tregtar dhe ta publikoje ate.
2. Banka do te beje Mareveshje Menaxhimi me Banken Arabe Islamike (E.C.) sipas se ciles e dyta do ti siguroje bankes sherbime teknike dhe menaxhimi per nje periudhe prej tre vjetesh e cila mund te perterihet dhe per periudha te tjera te ngjashme.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 9 :**

Shpenzimet, detyrimet dhe komisionet e kryera nga Banka gjate kohes se inkorporimit (duke e perfshire kohen e inkorporimit) jane llogaritur ne 100,000 USD (njeqindmije USD)

### **NENI 10 :**

Nenet e Statutit te bashkengjitura do te konsiderohen si shtese e Memorandumit te Statutit dhe prandaj do te konsiderohen si nje pjese integrale e tij, subjekt i aprovimit te Bankes se Shqiperise.

Nenshkruesit e autorizuar per partneret :

(Firmosur)

Banka Kombetare Tregtare Shqiptare  
(Spiro Brumbulli)  
Banka Islamike e Zhvillimit

Hamed H. Mutabagani

Adnan H. Bogary

Hayder Bin Laden

Brother Co.

Amal Bogary

Banka Arabe Islamike (E.C.)

Grupi Dallah Al - Baraka

Hisham Ali Hafiz

Solaiman A. Elkhareiji

Business Focus SDN BHD  
(Azhar Shah Bin Omar Shah)

Faisal Elkhareiji

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

Aksioneri, aksionet e te cilit jane dhene ne ngarkim ose jane hipotekuar nuk do te kete te drejtat e antaresise ne Banke.

### **NENI 11 : REGJISTRI I CERTIFIKATAVE TE AKSIONEVE**

Banka do te mbaje nje regjister I cili do te permbaje emrat e aksionereve, kombesite, vendbanimin, numrin dhe sasine e aksioneve te tyre si dhe te regjistroje ndryshimet e bera.

### **NENI 12 : TRANSFERIMI, DHENIA DHE HIPOTEKIMI I AKSIONEVE**

1. Organizatoret nuk mund te bejne sistemimin e aksioneve te tyre pa kaluar dy vjet nga data e inkorporimit te Bankes. Megjithate gjate kesaj periudhe aksionet e nenshkruara mund te sistemohen vetem ne rrethanat e meposhtme :
  - a) Disponimi i trashegimtarit ne rastin e vdekjes se aksionerit themelues ; dhe
  - b) Shperberja e Bankes ne rastin kur aksioneri organizues behet nje person juridik. Megjithate, kjo mund te evidentohet vetem ne nje kontrate shitjeje e bere ne perputhje me keto nene dhe mbas aprovimit te autoriteteve perkatese.
2. Mbas kalimit te dy vjeteve nga dita e fillimit te veprimtarise per organizatoret, ata dhe te tjeret mund ti shesin aksionet ne perputhje me Statutin e Bankes.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

3. Pavaresisht nga dispozitat e paragrafeve te mesiperm, shitja ose lenia ne dispozicion e aksioneve nuk do te jete efektive ne drejtim te kompanise se paleve te treta ne qoftese ajo nuk eshte regjistruar ne regjistrin special sipas nenit te meparshem.
4. Aksioneret e Bankes do te kene perpresine per blerjen e aksioneve nga shitesi dhe zevendesimin e tij ne qofte se ai i jep aksionet e tij, dhe kjo do te behet ne njeren nga menytrat e meposhtme :
  - a) Personi qe do te shesi ose do te japi aksionet e tij duhet te njoftoje drejtorine e Bankes per deshiren e tij per te shitur ose per te dhene aksionet e tij dhe deklarone cmimin qe kerkon per aksionet.
  - b) Keshilli Drejtues, duhet te njoftoje partneret e bankes per deshiren e partnerit per dhenien e aksioneve te tij dhe cmimin e kerkuar si dhe ti informoje ata se kane prioritet ne blerjen e aksioneve te ofruara dhe per ti zoteruar ato. Partneret duhet te informojne per deshiren e tyre brenda gjashtedhete diteve nga marrja e njoftimit.
  - c) Kur Bordi i Bankes merr miratimin per deshiren e aksionereve per blerjen e aksioneve, keto aksione do t'u jepen ne raport me aksionet qe ata zoterojne.
  - d) Ne qofte se drejtuesit e bankes nuk marin ndonje pergjigje rreth deshires per te blere aksione nga aksioneret qe kane te drejten e prioritetit, transferimi i aksioneve do te behet sipas menyres se specifikuar ne paragrafin (5) te ketij Neni.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

- e) Aksionet e lena si trashëgimi do të jepen sipas dispozitave të paragrafeve a, b, c, dhe d si më sipër.
- 5) Aksionet do të shiten në një mbledhje në të cilën marrin pjesë dy palë kontraktuese ose përfaqësuesit e tyre ligjorë, sekretari i Bankës dhe një përfaqësues për të bërë kontratën e shitjes ndërmjet dy palëve kontraktuese. Banka mund të bëjë dakord për të transferuar pronësinë e aksioneve të saj në bazë të një dokumenti shitje formuluar në përputhje me praktiken e aprovuar në tregun financiar të licensuar për të vepruar në Shqipëri. Në të gjitha rastet, Banka mund të refuzojë të nënshkruajë shitjen në rastet e mëposhtme :
- a) Në qoftë se aksionet janë hipotekuar me një urdher të Gjykatës;
  - b) Në qoftë se aksionet ose certifikatat kanë humbur dhe nuk janë lëshuar aksione të reja ose certifikata për zëvendësimin e tyre;
  - c) Në qoftë se shitja ose transferimi i pronësisë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit ose me Nenet e këtij Statuti; dhe
  - d) Në qoftë se Banka ka një borxh kundrejt aksioneve, ajo mund të bllokojë regjistrimin e transferimit të aksioneve përderisa borxhi i saj të zgjidhet.
6. Nënshkruesi i parë i aksioneve si dhe ata të emëruar me vone, pavarësisht se se transferimi është regjistruar në regjistrin e Bankës, do të mbeten bashkërisht përgjegjës për aksionet e tyre ose për ndonjë shumë të mbetur, përderisa të paguhet vlera e aksioneve.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

7. Banka mund ta ndaloje regjistrimin e aksioneve gjate periudhes ndermjet dates se fteses per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme dhe dates se kesaj mbledhjeje.
8. Aksionet gjithashtu mund te hipotekohen, falen ose te vihen ne dispozicion ne cdo forme tjetersimi dhe keto forma tjetersimi duhet te jene subjekt i paragrafeve te mesiperm. Gjendja e hipotekimit do te percaktohet nga data qe hipotekimi eshte regjistruar ne regjistrin special.
9. Banka do te ngarkoje nje pagese e cila do te percaktohet nga Keshilli Drejtues per regjistrimin e pronesise ose hipotekimit te aksioneve.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NDRYSHIMI I KAPITALIT TE BANKES**

#### **NENI 13 : NDRYSHIMI I KAPITALIT TE BANKES**

Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme mund te nxjerre nje vendim per te rritur kapitalin e Bankes dhe te percaktoje menyren sipas se ciles do te kryhet kjo rritje duke percaktuar se vlera nominale e aksioneve te reja te jete e njejte me ate te aksioneve origjinale. Megjithate, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose te shtoje nje pagese per vleren nominale te aksioneve te reja per te qene te barabarta me vleren nominale te aksioneve origjinale. Megjithate, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose te shtoje nje pagese ne vleren nominale dhe te percaktoje vleren e nje pagese te tille dhe shuma neto e pageses se permendur duhet te shtohet ne Rezerven e Pergjithshme, edhe neqoftese ajo eshte e barabarte me gjysmen e kapitalit. Ne te gjitha rastet vendimi per rritjen e kapitalit nuk mund te merret perpara aprovimit paraprak te Bankes se Shqiperise.

#### **NENI 14 : ZVOGLIMI I KAPITALIT TE BANKES.**

1. Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme mund te vendose per zvoglimin e kapitalit te Bankes ne rastin kur kapitali eshte mbi nevojat e Bankes ose ne rastin e perballimit te ndonje humbje dhe Banka vendos te zvogeloje kapitalin ne vleren aktuale, pas marrjes se aprovimit paraprak nga Banka e Shqiperise.

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

2. Zvoglimi i kapitalit do te behet me njeren nga menytrat e meposhtme :
  - a) Zvoglimi i vleres nominale te aksioneve duke ju ri-paguar aksionereve pjese te kesaj vlere ose duke i zbritur ato nga vlefte e pasiveve per te paguar pjese te vleres se papaguar te aksioneve.
  - b) Zvoglimi i vleres nominale te aksioneve dukeanceluar pjese te kesaj vlere.
3. Nje vendim per zvoglimin e kapitalit mund te merret vetem pasi eshte lexuar raporti i Kontrollorit per arsyeset qe kerkojne nje zvoglim te tille, pasivet e Bankes dhe efektet e zvoglimit te kapitalit ne keto pasive.
4. Neqoftese zvoglimi i kapitalit do te behet duke ri paguar pjese te vleres se aksioneve per aksioneret, zvoglimi nuk do te jete i vlefshem per ata kreditore te cilet kane shprehur verejtjet e tyre brenda gjashtedhjete diteve nga dita e publikimit te vendimit per zvoglimin e kapitalit ne Gazeten Zyrtare dhe kane paraqitur dokumentat e tyre brenda kesaj periudhe po te mos kene mbledhur ne kohe borxhet e tyre te pagueshme dhe te kene marre garanci te mjaftueshme per grumbullimin e borxheve te tyre te ardhshme.

# **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

## **ADMINISTRIMI I BANKES**

### **KAPITULLI 4**

#### **BORDI I DREJTOREVE (KESHILLI DREJTUES)**

##### **NENI 15 : KESHILLI DREJTUES DHE AFATET E FUNKSIONIMIT**

1. Banka do te administrohet nga nje Keshill Drejtues i perbere prej 9 anetare. Keshilli i pare Drejtues perbehet prej 7 anetare, prej te cileve 3 do te jene te perhershem, nje prej tyre perfaqeson Banken Kombetare Tregtare te Shqiperise, nje perfaqeson Banken Arabe Islamike, Bahrein, nje perfaqeson Banken Islamike per Zhvillim, Jeddah dhe kater anetaret e tjere do te zgjidhen ndermjet gjithë aksionereve. Anetaret do te zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme. Afati i veprimtarise se Keshillit do te jete tre vjet dhe nje anetar mund te ri-zgjidhet nje ose me shume here.
2. Keshilli Drejtues do te zgjedhe Kryetarin dhe Zv. Kryetarin per te njejtin afat si dhe vete Keshilli. Keshilli Drejtues mund te zgjedhe gjithashtu midis anetareve te tij, duke perfshire Kryetarin dhe Zv.Kryetarin, nje ose me shume Drejtore Ekzekutive te cilet do te kene te drejte te firmosin per Banken bashkerisht ose vecmas ne perputhje me vendimin e Keshillit Drejtues te marre per kete ceshtje.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

2. Drejtori Ekzekutiv duhet te jete Shefi Ekzekutiv i Bankes dhe do te kete fuqite e percaktuara ne Nenet Statutit ose te dhena nga Keshilli Drejtues.

### **NENI 16 : KUSHTET E ANETARESIMIT NE KESHILLIN DREJTUES**

Nje anetar i Keshillit Drejtues duhet te plotesoje kushtet e meposhtme :

1. Ai nuk duhet te jete denuar per ndonje kundravajtje ose per krim vjedhjeje, shperdorim, humbje besimi, leshimin e ndonje ceku te pavlefshem ose te falsifikuar, falimentim ose shkelje te ligjeve.
2. Ai duhet te jete posedues i nje numer aksionesh me nje vlere minimale prej jo me pak se 100,000 US Dollare.

### **NENI 17 : PLOTESIMI I VENDEVE BOSH**

1. Ne rastin kur vendi i nje anetari te Keshillit Drejtues mbetet bosh, Keshilli mund te emeroje nje anetar tjeter ne vend te tij dhe nje emerim i tille duhet t'i paraqitet Asamblese se Pergjithshme te Zakonshme ne mbledhjen e saj te pare per aprovimin e kesaj kandidature ose te emeroje nje anetar tjeter ne vend te tij.
2. Ne rastin kur vendet bosh ne Keshillin Drejtues perbejne nje te katerten e numrit te pergjithshem.
3. Ne te gjitha rastet, anetari i ri do te plotesoje kohen e mbetur te paraardhesit te tij.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 18 : FUNKSIONET E KESHILLIT DREJTUES**

1. Keshilli Drejtues duhet te ndermarre te gjitha veprimet e kerkuara per administrimin e Bankes ne perputhje me objektin e saj. Keto fuqi nuk do te kufizohen pervecse ne rastet kur eshte parashikuar ndryshe nga ligji, nga Nenet e ketij Statuti ose nga vendimet e Asamblese se Pergjithshme. Keshilli, vecanerisht, duhet te pregatise rregulloret e brendeshme per organizimin e punes dhe drejtimin e bankes, te emeruje ose te pushoje Drejtorin e Pergjithshem ose drejtoret, mbikqyresit dhe stafin, te specifikoje funksionet e secilit prej tyre, te percaktoje shperblimin e tyre dhe shumen e garancive qe secili prej tyre duhet te jape kur eshte e nevojshme, te aprovoje terheqjet, blerjet dhe shitjet e pasurive te tundshme dhe te patundshme, te gjitha te drejtat dhe koncensionet, te tundshme ose te pa tundshme, te jape me qera dhe te autorizojte terheqjet e fondeve dhe letrave me vlerë te zoteruara nga Banka si dhe transferimin dhe shitjen e tyre, te autorizojte institucionin per cdo veprim ligjor dhe mbrojtjen e interesave te Bankes perpara Gjykates qofte kur Banka eshte e paditur ose paditese, perfundon marreveshjen e pajtimit dhe gjykimit,ancelon kontrata dhe heq dore nga koncesionet me ose pa konsiderate dhe vendos per menyren e perdorimit te fondeve te Bankes.
2. Ne vijim te funksioneve te percaktuara ne paragrafin e mesiperem, Keshilli Drejtues mund te nxjerre programe speciale per menaxhimin e fondeve speciale te investimit dhe programe lidhur me projekte te rendesishme ose te atyre te financuara nga kapitali investues te ofruara ne formen ose kontraten e pjesmarjes ne ndarjen e fitimit ose forma te tjera qe mund te realizojne objektivat e Bankes.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 19 : PERFAQESIMI I BANKES DHE FIRMOSJA PER TE.**

Kryetari i Keshillit Drejtues ose zevendesesi i tij ose Drejtori Ekzekutiv i emeruar nga Keshilli Drejtues, do te perfaqesojne Banken para ligjit dhe gjithë paleve te tjera dhe do te kene fuqine per te firmosur per te. Keshilli Drejtues ne vendime te vecanta do te emeruje persona te autorizuar ndermjet stafit te drejtuesve te cilet kerkohen sipas natyres se punes per t'ju dhene fuqine per te firmosur ne emer te Bankes sic procedohet normalisht ne institucionet bankare.

### **NENI 20 : Mbledhja e Keshillit Drejtues**

1. Keshilli Drejtues do te mblidhet me kerkesen e Kryetarit ose te zevendesit te tij ose me ftesen e te pakten nje anetari, te pakten kater here ne vit ne te njejtin vit fiskal. Mbledhjet e Keshillit Drejtues do te behen ne Republiken e Shqiperise pervec rasteve kur Keshilli vendos ndryshe.
2. Nje anetar i Keshillit Drejtues mund te delegoje nje person tjeter te marre pjese ne emer te tij me kusht qe personi i deleguar te jete nje anetar Keshilli dhe me kusht qe numri i te deleguarve te mos kaloje nje te treten e anetareve. Delegimet duhet te percaktohen dhe evidentohen me shkrim dhe ti dergohen Keshillit Drejtues te pakten tre dite perpara mbledhjes.

### **NENI 21 : Vendimet e Keshillit Drejtues**

Vendimet e Keshillit Drejtues do te merren me shumicen e votave te personave prezent ose te perfaqsuar 50% plus one. Ne rastet kur ka barazim, Kryetari ose personi qe vepron ne emer te tij ka te drejten e shortit dhe anetari qe nuk eshte dakord duhet te regjistroje verejtjet e tij ne Proces Verbalin e Mbledhjes.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 22 : PERGJEGJESITE E KESHILLIT DREJTUES**

1. Keshilli Drejtues dhe anetaret e tij do te jene pergjegjes para Bankes, Aksionereve dhe paleve te treta per te gjitha veprimet mashtruese, abuzim me postin e tyre, per ndonje shkelje te Ligjit , Neneve te Statutit si dhe per drejtim te keq. Nje votim nga Asambleja e Pergjithshme per shkarkimin e Keshillit Drejtues nga pergjegjesi te tilla nuk e ndalon institucionin per veprim ligjor ne pergjegjesi.
2. Banka do te pregatise cdo vit nje liste te detajuar, te apovuar nga Keshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv, me emrat e Kryetarit te Keshillit, anetareve dhe menaxhereve te tij dhe cilesite e tyre si dhe menaxheret e bankes dhe Banka do te mbaje nje kopje nga kjo liste dhe te percjelle origjinalin tek autoritetet perkatese Shqiptare te shoqeruar me raportin vjetor te pregatitur nga Keshilli drejtues, me bilancin e Bankes si dhe llogarine e saj humbje fitime. Banka do te njoftoje keto autoritete per ndonje ndryshim qe mund te ndodhe ne liste gjate vitit. Nje kopje tjeter e ketyre te dhenave duhet ti percillet Bankes se Shqiperise.
3. Per cdo vit fiskal dhe brenda periudhes se lejuar per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve dhe brenda nje periudhe kohe maksimumi tre muaj nga dita e perfundimit te vitit financiar, Keshilli Drejtues do te pregatise nje raport per aktivitetin financiar te Bankes gjate ketij viti fiskal, pozicionin e saj financiar, bilancin dhe llogarine humbje fitim dhe Kryetari i Keshillit dhe Drejtori Ekzekutiv duhet te firmosin raportin, bilancin dhe llogarine humbje fitim.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

4. Keshilli Drejtues mund te vendose te therrese nje mbledhje speciale ne te cilen ftohen mbajtesit e depozitave te vazhdueshme me jo me pak se 100,000 US Dollare per t'ju dhene atyre mundesine per te shprehur mendimin dhe komentet e tyre mbi politikat e investimit dhe te drejtat e tyre me Banken.

### **NENI 23 : SHPERBLIMI I KESHILLIT DREJTUES.**

Pas marrjes se aprovimit paraprak nga Banka e Shqiperise, mbledhja e Pergjithshme e Zakonshme vendos per shperblimin e anetareve te Keshillit dhe nje shperblim i tille nuk duhet te tejkaloje 10 % te fitimit neto te Bankes mbas zbritjes se shumave per rezerva dhe shperndarjes se dividendeve per aksioneret qe shkon ne shumen jo me pak se 5 % te kapitalit te paguar.

### **NENI 24: RASTET E HUMBJES SE ANETARESISE TE ANETARIT TE KESHILLIT**

Nje anetar i Keshillit Drejtues mund te humbase anetaresine e tij ne Keshillin Drejtues ne rastet e meposhtme :

1. Ai mungon ne kater mbledhje te njepasnjeshme pa aresye te perligjur, me nje vendim te marre nga Keshilli Drejtues.
2. Neqoftese ai jep doreheqjen me shkrim.
3. Neqoftese ai shkel ndonje nga kushtet e percaktuara ne Nenin 26.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

4. Neqoftese ai mbulon ndonje pozicion tjeter ne Banke pervec atij te Kryetarit te Keshillit ose te Drejtorit Ekzekutiv per te cilin merr shperblim.

### **NENI 25 : PROCES VERBALI I MBLEDHJEVE**

1. Proces verbali i mbledhjes se Keshillit Drejtues do te mbahet ne nje regjister special dhe proces verbali do te formoset nga anetaret te cilet marrin pjese ne mbledhje dhe nga sekretari i Keshillit Drejtues.
2. Nje anetar i cili ka verejtje per ndonje vendim te marre nga Keshilli, duhet ti paraqese verejtjet e tij ne Proces Verbalin e mbledhjes dhe firmat ne Proces Verbal duhet ti pergjigjen me perpikmeri hollesirave ne te.

### **NENI 26 : KRIJIMI I KOMITETIT EKZEKUTIV DHE CAKTIMI I FUNKSIONEVE TE TIJ**

1. Keshilli Drejtues mund te krijojte nje Komitet Ekzekutiv nga anetaret e tij duke perfshire Drejtorin e Pergjithshem jashte Keshillit, duke percaktuar se numri i anetareve te Komitetit Ekzekutiv nuk mund te jete me pak se tre. Drejtori Ekzekutiv do te jete Kryetar i Komitetit Ekzekutiv dhe gjate mungeses se tij ai mund te delegoje ndonje nga anetaret e Komitetit.
2. Komiteti Ekzekutiv do te ri-zgjidhet me ri-zgjedhjen e Keshillit Drejtues dhe te njejtet anetare mund te emerohen nje ose me shume here.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

3. Keshilli Drejtues mund te autorizoje Komitetin Ekzekutues per ushtrimin e funksioneve te caktuara si mund te gjykohet e nevojshme dhe e pershtatshme per natyren e punes se Bankes dhe per zhvillimin e saj.
4. Komiteti Ekzekutiv do te mblidhet te pakten 6 here ne vit. Megjithate, ai mund te mblidhet cdo here sipas rrethanave te kerkuara te punes sic mund te vendoset nga Kryetari dhe aprovohet nga anetaret e tjere.
5. Quorumi per Komitetin Ekzekutiv do te jete minimumi gjysma e anetareve te tij dhe vendimi do te merret me shumice votash. Ne rast barazimi, Kryetari do te kete te drejten e votes me short duke percaktuar se pjesmarrja duhet te jete personalisht.
6. Proces Verbali i mbledhjes se Komitetit Ekzekutiv do te mbahet ne nje regjister special dhe ky proces verbal do te firmoset nga anetaret qe kane marre pjese ne kete mbledhje. Anetaret qe kane verejtje per vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv duhet ti regjistrojne verejtjet e tyre ne proces verbalin e mbledhjes dhe firmat ne proces verbal duhet ti pergjigjen me perpikmeri hollesirave ne te.
7. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv do ti paraqese Keshillit Drejtues ne cdo mbledhje te tij, nje raport te permbledhur rreth vendimeve te marra qe nga mbledhja e fundit e ne vazhdim brenda kopetencave te Komitetit. Keshilli Drejtues ka te drejten e konfirmimit te ndryshimit.

### **NENI 27 : KOMITETI I KONTROLLIT TE BANKES DHE STAFI**

1. Ne perputhje me ligjin e Sistemit Bankar, Keshilli Drejtues do te emeroje nje Komitet Kontrolli te Brendshem.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

2. Keshilli Drejtues do te zgjedhe ndermjet anetareve te vet nje Drejtor Ekzekutiv dhe mund ta autorizojte ate qe te veproje si Drejtor i Pergjithshem per Banken dhe te percaktojte funksionet e tij dhe ai duhet te siguroje nje drejtim te qete te biznesit te Bankes. Keshilli Drejtues gjithashtu mund te emeruje nga brenda ose jashte bankes nje Drejtor te Pergjithshem per Banken per te bashkepunuar me Drejtorin Ekzekutiv per zbatimin e politikave te pregatitura nga Keshilli Drejtues.
3. Drejtori i Pergjithshem do te ndihmohet ne detyren e tij nga Zv. Drejtori i Pergjithshem i zgjedhur nga stafi me me shume eksperience dhe aftesi si dhe nga nje numer i pershtatshem drejtoresh departamentesh, senior, punonjesit e administrates etj.
4. Keshilli Drejtues duhet te sigurohet qe eshte pregatitur nje sistem dhe kod praktik i gjithanshem, i tille qe te mundesojte banken per te terhequr kuadro te kualifikuara dhe specializuara ne operacionet investuese nderkombetare sidomos ne metodat e reja dhe moderne te pjesmarjes ne investime si dhe teknika te tjera moderne.



# **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

## **KAPITULLI 5**

### **ASAMBLETE E PERGJITHSHME**

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### **NENI 28 : FTESA PER THIRJEN E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Njoftimet per te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme per aksioneret duhet te publikohen ne dy gazeta lokale ne Arabisht dhe Anglisht, te pakten pesembedhjete dite perpara dates se caktuar te mbledhjes. Megjithate, do te ishte e mjaftueshme ti dergohet njoftimi aksionerve me poste te pakten pesembedhjete dite para dates se caktuar te mbledhjes dhe nje kopje e njoftimit ti percillet autoriteteve perkatese Shqiptare te pakten dhjete dite para mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

#### **NENI 29 : RENDI I DITES**

1. Themeluesit do te pregatisin rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme e mbledhur si Asamble Kushtetuse, ndersa Keshilli Drejtues do te pregatise rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme e mbledhur si Asamble e Zakonshme ose e Jashtezakonshme.
2. Ne rastet kur Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet me kerkesen e aksionereve, kontrolloreve ose autoriteteve perkatese, rendi i dites do te pregatitet nga ata qe kerkojne te mbahet mbledhja. Asnje ceshtje qe nuk eshte percaktuar ne rendin e dites nuk mund te diskutohet.



## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

### NENI 30 : VOTIMI

1. Cdo aksioner do te kete te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe do te kete nje numer votash te barabarte me numrin e aksioneve qe mban dhe personat qe mungojne do te perfaqesohen nga perfaqesuesit e tyre ligjore.
2. Per pjesmarjen ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme duhet te leshohet nje autorizim duke percaktuar se ky autorizim eshte leshuar me shkrim. Asnje anetar nuk do te mare pjese ne votim ne emer te tij ose ne emer te atyre qe perfaqeson, per ceshtje ne te cilat ai ka interes personal ose per ceshtje qe lidhen me ndonje mosmarveshje midis tij dhe Bankes.
3. Votimi ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme do te jete me ngritjen e dorës ose me ndonje menyre tjeter sipas aprovimit te Asamblese se Pergjithshme. Votimi do te behet me votim sekret per vendime qe kane te bejne me zgjedhjen ose largimin e Anetareve te Keshillit Drejtues ose me zbatimin e ndonje detyrimi ligjor ne detyrimet kunder tyre ose me kerkesen e kryetarit te Keshillit Drejtues ose nga nje numer aksioneresh qe perfaqesojne te pakten nje te terten e votave te perfaqesuara ne mbledhje.
4. Anetaret e Keshillit Drejtues nuk mund te marrin pjese ne votimin e nje vendimi te Asamblese se Pergjithshme qe shkarkon ata nga ndonje detyrim.

### NENI 31 : REGJISTRIMI

1. Aplikimet per pjesmarrje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme duhet te regjistrohen ne nje regjister te vecante ne Drejtorine e Bankes dhe nje regjistrim i tille duhet te behet te pakten njezet e kater ore perpara.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

2. Ne kete regjister duhet te regjistrohen emrat e aksionereve prezent dhe te atyre qe marrin pjese ne emer te te tjereve, numri i aksioneve qe zoterojne ose perfaqesojne, numri i fuqive te autorizuarra dhe numri i votave qe kane te drejte personalisht ose me autorizim.

### **NENI 32 : PROCES VERBALET E MBLEDHJEVE**

Kryetari i Asamblese se Pergjithshme do te caktoj midis aksionereve ose te tjereve nje sekretar per regjistrimin e zhvillimit te mbledhjes dhe vendimet e marra ne te dhe keto procedura duhet te regjistrohen ne proces verbalin e firmosur prej tij dhe nga Kryetari. Me aprovimin e Asamblese se Pergjithshme, dy persona do te caktohen per numerimin e votave.

### **NENI 33 : VENDIMET E ASAMBLEVE TE PERGJITHSHME**

Vendimet e marra nga Asamblete e Pergjithshme ne perputhje me ligjin dhe me nenet e ketij Statuti, do te jene te detyrueshme per te gjithe aksioneret si ne rastin kur ata jane prezent ne mbledhjen ne te cilen jane marre vendimet edhe kur kane munguar, si ne rastin kur ata i kane aprovuar dhe ne rastin kane votuar kunder.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **ASAMBLEJA KUSHTETUESE**

#### **NENI 34 : MBLEDHJA**

1. Themeluesit do te ftojne aksioneret per te marre pjese ne Asamblene Kushtetuese.
2. Asambleja Kushtetuese do te kryesohet nga personi qe zgjidhet nga shumica e anetareve te pranishem.

#### **NENI 35 : QUORUMI**

1. Qe mbledhja e Asamblese Kushtetuse te jete e vlefsheme, duhet te jene prezent nje numer aksioneresh qe te perfaqesojne te pakten 50 % te kapitalit.
2. Ne qoftese ne mbledhje nuk arrihet quorumi i percaktuar ne paragrafin e mesiperm, do te dergohet nje ftese per thirrjen e nje mbledhjeje te dyte brenda tridhjete diteve nga data e caktuar per mbledhjen e pare dhe procedurat e ftesave do te jene te njejta me ato te mbledhjes se pare. Mbledhja e dyte do te jete e vlefshme me numrin e aksionereve te paraqitur.
3. Vendimet e Asamblese Kushtetuese do te merren me shumicen absolute te aksioneve te perfaqesuara.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 36 : TE DREJTAT DHE PERGJEGJESITE**

1. Asambleja Kushtetuese do te diskutoje vetem raportin e themeluesve per procesin e inkorporimit dhe shpenzimet si dhe vlereson aksionet ne vecanti sipas dispozitave te caktuara ne Ligj. Gjithashtu ajo do te zgjedhe Keshillin e pare Drejtues dhe kontrolloret dhe do te deklaroje inkorporimin perfundimtar te Bankes.
2. Keshilli i pare Drejtues do te regjistroje Memorandumin dhe Nenet e Statutit ne Regjistrin Tregtar ne perputhje me dispozitat e Ligjit. Anetaret e Keshillit Drejtues do te jene pergjegjes bashkerisht per ndonje pasoje qe mund te rrjedhe nga mos zbatimimi i ketyre procedurave.

### **ASAMBLETE E PERGJITHSHME TE ZAKONSHME**

### **NENI 37 : MBLEDHJA**

1. Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Pergjithshme do te mbahet me kerkesen e Kryetarit te Keshillit Drejtues, ne Drejtorine Qendrore te Kompanise, te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve te pare pas perfundimit te vitit financiar te Bankes. Megjithate Keshilli Drejtues mund te kerkoje qe mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Pergjithshme te thirret sa here ta gjykoje te nevojshme.

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

2. Keshilli Drejtues do te therrese Mbledhjen e Zakonshme te Asamblese se Pergjithshme sa here qe kerkohet nga kontrolloret ose nga nje numer aksioneresh qe perfaqesojne nje te treten e kapitalit te Bankes.
3. Gjithashtu kontrolloret mund te kerkojne per tu mbledhur Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme neqoftese Keshilli Drejtues nuk i jep atyre te drejtat qe i takojne sipas ligjit, me kusht qe kjo duhet te pasqyrohet ne nje raport i cili duhet t'i paraqitet Keshillit.
4. Banka e Shqiperise mund te kerkoje mbledhjen e Zakonshme te Asamblese se Pergjithshme, neqoftese mbas nje muaji nga data ne te cilen ishte parashikuar te mblidhej Asambleja e Pergjithshme nuk eshte derguar ftese per thirrjen e mbledhjes ose neqoftese numri i anetareve te keshillit Drejtues shkon nen nivelin minimal te kerkuar qe mbledhja te jete e vlefshme ose neqoftese kjo eshte kerkuar nga nje numer aksioneresh qe perfaqesojne 10 % te kapitalit duke percaktuar se ata kane aresye te verteta per ta mbeshtetur kerkesen e tyre.

### **NENI 38 : QUORUMI**

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme do te drejtohet nga Kryetari i Keshillit Drejtues ose ne mungese te tij nga zevendesi i tij ose nga ndonje person tjeter i emeruar per kete qellim nga Keshilli Drejtues ose nga Asambleja e Pergjithshme. Kryetari do te caktojte nje sekretar ose dy sekretare per numerimin e votave duke theksuar se Asambleja e Pergjithshme e aprovon emerimin e tyre. Mbledhja nuk do te jete e vlefshme neqoftese nuk do te marrin pjese nje numer aksioneresh qe perfaqesojne vleren e te pakten gjysmes se aksioneve. Neqoftese nje quorum i tille nuk arrihet ne mbledhjen e pare duhet te dergohet nje ftese tjeter per thirrjen e mbledhjes se dyte brenda gjashtedhjete diteve nga mbledhja e pare dhe kjo mbledhje do te jete e vlefshme pavaresisht nga numri i pjesmaresve ne te.



## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

### NENI 39 : VOTIMI

Vendimet do te kalojne me shumicen absolute te aksioneve te perfaqesuara ne mbledhje. Ne rast barazimi, Kryetari i mbledhjes do te beje votimin me short.

### NENI 40 : FUNKSIONET E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme do te jete kompetente per te gjitha ceshtjet qe lidhen me Banken pervec atyre te parashikuara ne Ligj, ne keto Nene te Statutit per Asamblene Kushtetuese ose per Asamblene e Pergjithshme te Jashtezakonshme. Vecanerisht ajo do te jete kompetente per vendimet per emerimin e anetareve te Keshillit Drejtues dhe te kontrolloreve te jashtem si dhe caktimin e shperblimit te tyre per cdo vit, te aprovoje bilancin, llogarine humbje fitim, raportin e Keshillit Drejtues, menyren e perdorimit te fitimit neto, perqindjen e dividendeve, shkarkimin e anetareve te Keshillit Drejtues nga detyrimet. Asambleja nuk do te diskutoje ceshtje te pa pershira ne rendin e dites, por mund te diskutoje ceshtje urgjente qe mund te dalin gjate mbledhjes dhe qe propozohen nga nje numer aksioneresh qe perfaqesojne 50 % (pesedhjete perqind) te kapitalit te nenshkruar.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **MBLEDHJA E JASHTEZAKONSHME E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

#### **NENI 41 : MBLEDHJA**

Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Pergjithshme do te mblidhet me kerkesen e Keshillit Drejtues ose me nje kerkese paraqitur ne Keshillin Drejtues nga nje numer aksioneresh qe perfaqesojne te pakten 50 % te aksioneve. Ne rastin e fundit, ftesa per mbledhje do te behet brenda nje muaji nga data e marrjes ne dorezim te kerkeses nga Keshilli Drejtues.

#### **NENI 42 : QUORUMI**

Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Pergjithshme nuk do te jete e vlefshme neqoftese ne te nuk do te marrin pjese aksionere qe perfaqesojne shtatedhete e pese perqind te kapitalit te Kompanise. Neqoftese nje quorum i tille nuk arrihet, duhet te dergohet ftese per thirrjen e nje mbledhje te dyte e cila duhet te mbahet brenda tridhete diteve pas mbledhjes se pare dhe kjo mbledhje do te jete e vlefshme neqoftese ne te marrin pjese aksionere qe perfaqesojne gjysmen e aksioneve. Vendimet ne te dyja mbledhjet do te aprovohen nga shumica dy te tretat e aksioneve te perfaqesuara.

Neqoftese quorumi i kerkuar nuk arrihet ne mbledhjen e dyte, duhet te dergohet thirrje per te mbajtur mbledhjen e trete e cila do te mbahet ne periudhen e tre muajve nga data e fteses per thirrjen e mbledhjes se dyte. Mbledhja e trete do te jete e vlefshme pavaresisht nga numri perfaqesuesve ne te. Vendimet ne mbledhjen e trete do te merren me shumicen e votave te pjesmaresve dhe do te jete subjekt i aprovimit nga Banka e Shqiperise.

#### **NENI 43 : FUNKSIONET E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE JASHTEZAKONSHME.**

Asambleja e pergjithshme e Jashtezakonshme do te kete kopetence te merret me ceshtjet e meposhtme :





## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

1. Ndryshimin e Memorandumit te Bankes ose te Statutit te saj ose zgjatjen e afatit te saj.
2. Rritjen e kapitalit te Bankes.
3. Shitjen e gjithë projektit te ndermare nga Banka ose shperndarjen me ndonje menyre tjeter.
4. Shperberjen e Bankes ose bashkimin e saj me ndonje kompani tjeter.
5. Zvoglimin e kapitalit te Bankes.

Perjashtim nga sa me siper, do te kete ndryshimi i objektit kryesor te Bankes, ndryshimi i kombesise, levizja e selise kryesore jashte Shqiperise dhe rritja e detyrimeve te aksionereve.



# BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

## KAPITULLI 6

### KOMITETI FETAR DHE KONTROLLORET E JASHEM

#### KOMITETI FETAR

##### **NENI 44 :**

Asambleja e zakonshme e pergjithshme do te zgjedhe dhe emeruje Bordin e Komitetit Fetar te Shariahit, me rekomandim te Keshillit Drejtues.

##### **NENI 45 :**

1. Komiteti Fetar do te siguroje qe investimet dhe aktivitetet e Bankes (si dhe ato te kompanive ndihmese ose te bashkuara me te) jane ne perputhje me Parimet Bankare Islamike. Brenda gjashte muajve nga perfundimi i vitit fiskal te Bankes, Komiteti do te paraqese nje raport me shkrim duke percaktuar se nepermjet ketij seksioni ai e ka kryer detyrimin e tij duke siguruar se te gjitha investimet dhe aktivitetet e Bankes (duke perfshire dhe ato te kompanive ndihmese) jane ne perputhje me Parimet Bankare Islamike.
2. Komiteti Fetar do te kete te njejtat fuqi me ato qe gezojne kontrolloret e jashtem. Procedurat e brendeshme te Komitetit do te rregullohen ne baze te rregullores se tij.
3. Keshilli Drejtues do te kete autoritet absolut per te caktuar shperblimin e anetareve te Komitetit Fetar.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **KONTROLLORET E JASHEM**

#### **NENI 46 :**

1. Banka do te kete nje ose me shume kontrollore te jashtem nga ata qe jane licensuar per te vepruar brenda ose jashte Shqiperise dhe do te emerohet nga Asambleja e Pergjithshme. Emerimi i tyre do te aprovohet nga Banka e Shqiperise.
2. Asambleja e Pergjithshme do te caktoje cdo vit shperblimin per Kontrolloret e Jashtem dhe ajo mund te caktoje Keshillin Drejtues qe ta beje kete.

#### **NENI 47 : FUNKSIONET DHE DETYRIMET E KONTROLLOREVE**

1. Kontrolloret e Jashtem do te kontrollojne llogarite e vitit financiar per te cilin ata jane emeruar ose per te cilin eshte rinovuar emerimi i tyre.
2. Kontrolloret kane te drejte ne cdo kohe te shikojne te gjitha te dhenat, librat dhe dokumentat dhe te kerkojne informacionin qe ata e gjykojne te domosdoshem. Ata gjithashtu mund te verifikojne aktivet dhe pasivet e Bankes dhe ne rast se ata nuk kane mundesi qe te ushtrojne keto te drejta ata duhet ta paraqesin kete ne nje raport me shkrim i cili duhet t'i paraqitet Keshillit Drejtues. Neqoftese Keshilli nuk lehteson detyren e tyre, ata mund te kerkojne te mblidhet Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme per te shqyrtuar kete ceshtje.



## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

3. Kontrollori i Jashtëm duhet të marrë pjesë gjithmone në mbledhjen Asamblese të Përgjithshme dhe do të paraqesë pikpamjet e tij mbi të gjitha çështjet lidhur me detyrën e tij dhe në veçanti për bilancin e Bankës si dhe do të lexojë raportin e tij në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Nëqoftesë Banka ka dy kontrollorë të Jashtëm dhe ata nuk bien dakord në një raport, secili prej tyre do të përgatisë një raport të veçantë.
5. Raporti i Kontrollorit të Jashtëm i përgatitur sipas standardeve profesionale ndërkombëtare do të lexohet në Asamblenë e Përgjithshme dhe secili aksioner ka të drejtë t'a diskutojë atë dhe të kërkojë sqarime për çështje të veçanta të shtruar në të.
6. Në rastin kur janë në shumicë votash, kontrollorët e jashtëm do të jenë të gjithë përgjegjës për veprimet e tyre kontrolluese.
7. Kontrollorët e Jashtëm do të përgatisin një raport të veçantë për operacionet investuese të depozitave të përbashkëta ose specifike dhe metodën e llogaritjes dhe shpërndarjes së fitimit të tyre. Ata gjithashtu do të përgatisin një raport për çdo operacion investues të veçantë dhe për personin përkatës që mund të ketë të drejtë në të.



# **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

## **KAPITULLI 7**

### **LLOGARITE E BANKES DHE VITI FISKAL**

#### **NENI 48 : VITI FISKAL I BANKES**

Viti fiskal i Bankes do te filloje ne 1 Janar dhe do te mbaroje ne 31 Dhjetor te cdo viti. Megjithate, viti i pare do te perfshije intervalin e kohes nga data e inkorporimit perfundimtar te Bankes deri ne 31 Dhjetor te te njejtit vit.

#### **NENI 49 : FONDET E BANKES.**

Banka do ti mbaje fondet e saj ne cash me nje ose me shume banka sipas vendimit te Keshillit Drejtues.

#### **NENI 50 : BILANCI VJETOR I BANKES DHE RAPORTI I KESHILLIT DREJTUES.**

1. Keshilli Drejtues do te pregatise per cdo vit si me poshte :
  - a) Bilancin e Bankes per vitin fiskal i cili do te permbaje aktivet dhe pasivet e Bankes.
  - b) Llogarine humbje fitim.
  - c) Nje raport te detajuar mbi aktivitetet e Bankes dhe gjendjen financiare ne fund te vitit fiskal dhe hollesi te detajuara per metoden e propozuar nga Keshilli per shperndarjen e fitimit neto te ketij viti, fitimet e mbartura nga viti i meparshem neqoftese ka. Ky raport duhet ti bashkengjitet bilancit.
2. Keshilli Drejtues do te publikoje bilancin, llogarine humbje fitim, nje permbledhje te detajuar te raportit vjetor si dhe tekstin e plote te raportit te Komitetit Fetar dhe te Kontrollorit te Jashtem ne te pakten nje gazete lokale.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 51 : PERCAKTIMI I FITIMIT NETO.**

Llogarite e fitimeve dhe humbjeve qe lidhen me aktivitetet financuese dhe investuese do te jene te ndara nga te ardhurat dhe shpenzimet nga aktivitetet dhe sherbimet e tjera te ofruara nga Banka Arabe Shqiptare Islamike. E njejta gje zbatohet edhe per te ardhurat dhe shpenzimet e investimeve specifike ku cdo projekt i vecante do te kete llogari te vecante.

Cdo shume qe mbetet nga fitimi bruto i Bankes pas zbritjeve te meposhtme do te konsiderohet fitim neto :

1. Shpenzimet e Pergjithshme.
2. Perqindja e percaktuar nga Keshilli Drejtues per amortizimin e aseteteve te Bankes dhe kompesimin e renies se vleres se tyre, duke percaktuar qe keto fonde do te perdoren per blerjen e materialeve te domosdoshme, pajisjeve dhe instalimeve ose per riparimin e tyre. Keto fonde nuk duhet te shperndahen ndermjet aksionereve.

### **NENI 52 : SHPERNDARJA E FITIMEVE NETO.**

1. Fitimet neto te Bankes do te shperndahen si me poshte :
  - a) Cdo vit 10 perqind e fitimeve neto do te zbriten dhe mbahen si rezerve ligjore. Kjo zbritje mund te nderpritet neqoftese rezerva arRin nje shume qe eshte e barabarte me 25 % te kapitalit nominal dhe kur kjo reserve fillon te ulet, perqindja e caktuar e zbritjes duhet te filloje te mbahet perseri deri sa te arrije nivelin e kerkuar. Rezerva Ligjore nuk mund te shperndahet tek aksioneret. Megjithate, ajo mund te perdoret per shperndarjen e kapitalit te paguar ne vitet kur fitimet e Bankes nuk lejonin pagesen e nje perqindjeje te tille. E gjithë kjo do te jete subjekt i aprovimit paraprak nga Banka e Shqiperise.
  - b) Nje perqindje e fitimeve e percaktuar nga Asambleja e Pergjithshme do te zbritet per te mbuluar dhe siguruar pasivet e Bankes.

## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

- c) Me rekomandim të Keshillit Drejtues, Asambleja e Pergjithshme vendos të zbrese një përqindje nga fitimet neto për Voluntary Rezerve dhe një rezervë të tilla do të përdoret për qëllimet e vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
  - d) Një shumë do të zbritet nga fitimet për shpërndarje si aksion nominal e cila është e barabartë me 5 % të vlerës së aksioneve të paguara, pas marrjes së aprovimit paraprak nga Banka e Shqipërisë.
  - e) Pas heqjes menjëherë të shumave të lartpërmendura, një shumë jo më e lartë se 10 % e mbetjes do të zbritet si shpërblim për anëtarët e Keshillit Drejtues.
  - f) Fitimi i mbetur do të shpërndahet për aksionerët si dividende shtesë, ose me sygjerim të Keshillit Drejtues do të kalojë për vitin e ardhshëm ose do të mbahet si fond special rezervë, subjekt i aprovimit nga Banka e Shqipërisë.
2. Humbjet, neqoftese ka, do të shpërndahen ndërmjet aksionerëve në proporcion me numrin e aksioneve të tyre dhe secili prej tyre nuk do të rëndohet me shumë se aksionet që ka.
  3. Banka Arabe Shqiptare Islamike mund të pranojë depozita në cash për investim në një projekt ose qëllim specifik. Rezultatet e një investimi të tilla do të jenë subjekt i marrëveshjeve të vecanta ndërmjet depozituesit dhe Bankës Arabe Shqiptare Islamike mbi baze të llogarive të vecanta të të ardhurave dhe shpenzimeve të projektit i dallueshëm nga të ardhurat dhe shpenzimet të lidhura me investimet e përbashkëta.
  4. Çdo humbje e shkaktuar që lidhet direkt me llogarinë e depozitës për investim special do të mbulohet nga ajo llogari duke përcaktuar se kjo nuk është për shkak të drejtimit të keq, mashtrimit, neglizhencës totale nga ana e drejtuesve të Bankës.



## **BANKA ARABE SHQIPARE ISLAMIKE**

5. Keshilltari Ligjor Islamik ose Komiteti mbikqyres i cili duhet te emerohet ne perputhje me keto dispozita duhet te sigurojne ekzistencen e nje baze doktrinale per te mbeshtetur ngarkimin e cdo humbjeje nga veprimet e investimeve te perbashketa per Banken Arabe Shqiptare Islamike.





# BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

## KAPITULLI 8

### MOSMARREVESHJET

#### **NENI 53: MOSMAREVESHJET NE LIDHJE ME AKSIONERET**

Shkeljet:

1. A. Ne qoftese ndonje nga palet aksionere shkel mareveshjen ose dispozitat e Statutit ose aktet nen ligjore ose ka verejtje ne zbatimin e politikes dhe procedurave, pergjegjesia do te jete sipas shkeljes.

Si zgjidhje fillestare duhet te ndermeret nje konsultim i dyanshem. Ne rast deshtimi, duhet t'i drejtohen nje arbitrazhi nderkombetar te njohur brenda 45 diteve pas fillimit te mosmarveshjes. Kjo do te behet ne Komitetin Fetar te Bankes.

1. B. Veprimi ose detyrimi kunder anetareve te Keshillit Drejtues per veprim te gabuar qe shkakton deme per aksioneret do te jete e drejte e Bankes qe do ti paraqitet Asamblese se Pergjithshme. Nga Asambleja e Pergjithshme do te merret nje vendim per te percaktuar masen e pergjegjesise dhe nje veprim i tille do te ndermerret nga Kryetari i Keshillit Drejtues. Neqoftese Kryetari eshte personi qe ka shkaktuar demin ose ndergjyqes me Banken, Asambleja e Pergjithshme do te zgjedhe nje anetar tjeter te Keshillit per te ndermarre veprimin ligjor dhe neqoftese ky veprim eshte kunder te gjithe anetareve te Keshillit Drejtues, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje person tjeter jashte anetareve te Keshillit Drejtues per te kryer veprimin ligjor.
2. Neqoftese Banka eshte ne proces likuidimi, likuidatori do te marre persiper veprimin ligjor i cili do te jete subjekt i nje vendimi nga Asambleja e Pergjithshme.
3. Cdo partner qe ka mosmareveshje te ketij lloji do te njoftoje Kryetarin e Keshillit Drejtues permes nje letre rekomande te pakten pesembedhjete dite parpara thirjes se mbledhjes se ardheshme te Asamblese se Pergjithshme.

## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

Kryetari i Keshillit Drejtues do t'a perfshije nje propozim te tille ne rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme. Neqoftese Asambleja e Pergjithshme do te hedhe poshte kete sugjerim, asnje partner nuk mund te propozoje ate perseri ne emer te tij.

### **NENI 54 : MOSMAREVESHJET NE LIDHJE ME DEPOZITUESIT INVESTUES**

1. Ndermarrja e veprimit per pergjegjesine kuder drejtuesve te Bankes per pune jo te mire e cila ka shkaktuar dem per depozituesit investues do te jete e drejte e Keshillit te saj Drejtues. Keshilli Drejtues do te marre nje vendim per te percaktuar veprimin ligjor dhe ky do te ndermerret nga Kryetari i Keshillit Drejtues.
2. Neqoftese Banka eshte ne proces likuidimi, likuidatori do te ndermarre veprimin ligjor dhe kjo do te jete subjekt i vendimit te Keshillit Drejtues.
3. Cdo depozitues investues i cili deshiron te ndermerret veprim ligjor kunder drejtuesve te Bankes per demet e shkaktuara ne depoziten e tij specifike te investimit, do te njoftoje Kryetarin e Keshillit drejtues permes nje letre rekomande per detaje mbi faktet e veprimit ligjor te ceshtjes dhe dokumentat e tij mbeshtetese. Kryetari i Keshillit Drejtues do t'a perfshije ceshtjen ne rendin e dites se mbledhjes se pare te Keshillit Drejtues. Keshilli Drejtues do te njoftoje ankuesin per vendimin e tij jo me vonë se gjashtedhete dite pas mbledhjes se Keshillit ne te cilen eshte vendosur per ceshtjen. Neqoftese Keshilli Drejtues e pushon ceshtjen brenda gjashtedhete diteve te permendura me siper ose kjo periudhe kalon pa ndonje pergjigje te dhene nga Keshilli, mbajtësi i depozites specifike te investimit, do t'i drejtohet nje organi kompetent.

# BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

## KAPITULLI 9

### MBYLLJA DHE LIKUIDIMI

#### **NENI 55 : MBYLLJA E BANKES**

Banka do te mbyllet per nje nga aresyet e meposhtme :

1. Kur ka skaduar afati i caktuar per veprimtarine e saj, po te mos jete rinovuar ky afat.
2. Neqoftese eshte deklaruar falimentim nga Banka e Shqiperise.
3. Neqoftese nepermjet bilancit del se Banka ka humbur rezervat e saj dhe tre te katertat e kapitalit te saj, Kryetari i Keshillit Drejtues do te therrese mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme si nje mbledhje te Jashtezakonshme per zgjidhjen e ceshtjes si per shperberjen e Bankes parpara afatit te saj, ose pakesimin e kapitalit te saj ose te marre ndonje mase tjeter te pershtatshme. Neqoftese Asambleja e Pergjithshme refuzon te mbylle Banken, cdo aksioner do te kete te drejte ta coje ceshtjen ne gjykate.



## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 56 : LIKUIDIMI I BANKES**

Banka do te likuidohet pas mbylljes se saj ne perputhje me dispozitat e mepostme :

1. Fuqite e anetareve te Keshillit Drejtues do te ndalojne pas shperberjes se Bankes. Megjithate ata do te vazhdojne te drejtojne Banken pas shperberjes dhe do te konsiderohen karshi paleve te tjera si likuidatore derisa te emerohet likuidatori te cilit ata do t'i dorezojne te gjitha llogarite dhe asetet e bankes, librat dhe dokumentat. Asambleja e Pergjithshme do te vazhdoje me fuqite e saj gjate periudhes se likuidimit duke qene te kufizuar vetem me aktet e likuidimit pa nderhyre ne fuqite e likuidatorit.
2. Gjate periudhes se likuidimit Banka do te mbaje frazen "nen likuidim".
3. Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje ose me shume likuidatore ndermjet aksionereve ose nga pale te tjera dhe do te caktoje shperblimin e tyre, dhe nje emerim i tille do te behet me shumicen e votave te kerkuara per te kaluar vendimet e Asamblese se Pergjithshme. Neqoftese eshte marre nje vendim per shperberjen e Bankes ose per anulimin e tij, Gjykata do te pershkruaje metoden e likuidimit ne perputhje me nenet e Statutit te Benkes, duke marre ne kosiderate natyren specifike te Bankes dhe do te emeruje likuidatorin dhe caktojeshperblimin e tij.



## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

4. Menjehere pas emerimit dhe aprovimit te tij nga Asambleja e Pergjithshme, likuidatori do te marre ne dorezim inventarin e aktiveve dhe pasiveve te Bankes dhe do te nxjerre nje gjendje te detajuar dhe bilancin te cilin ai duhet ta firmose me drejtoret.
5. Likuidatori nuk do te filloje aktivite te tjera biznesi neqoftese ato nuk jane te domosdoshme per plotesimin e biznesit te meparshem. Ai nuk mund te shese te gjitha asetet e Bankes pervecse me miratimin e Asamblese se Pergjithshme.
6. Likuidatori do te shese pasurite e tundshme dhe te patundshme te Bankes nepermjet ankandit publik ose ndonje metode tjeter po te mos jete specifikuar ne dokumentat e emerimit te tij se shitja do te behet me nje procedure te caktuar. Ai gjithashtu do te shlyeje detyrimet e Bankes kundrejt mbajtesve te depozitave te investimit dhe borxhet e tyre te pagueshme ose pagesat e shtyra ose borxhet e mosmarveshjeve.
7. Likuidatori do ti paraqese Asamblese se Pergjithshme nje llogari perfundimtare mbi procedurat e likuidimit dhe likuidimi do te gjykohe i kompletuar pas aprovimit te nje llogarie te tille. Pas kesaj, likuidatori do te fuse likuidimin perfundimtar ne Regjistrin Tregtar dhe do ta publikoje ate ne nje gazete lokale. Emri i Bankes dhe Regjistrimi Tregtar do te hiqen nga Regjistri Tregtar.

# **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

## **KAPITULLI 10**

### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **NENI 57 : LIBRAT E BANKES PAS LIKUIDIMIT**

Librat dhe dokumentat e Bankes do te mbahen per nje periudhe prej 10 vjet nga data e heqjes se emrit te Bankes nga Regjistri Tregtar dhe ne vendin e caktuar nga Asambleja e Pergjithshme.

#### **NENI 58 :**

Keto Nene te Statutit do te depozitohen dhe duhet te publikohet nje njoftim ne perputhje me Ligjin.

#### **NENI 59 :**

Gjuha e aktivitetit te Bankes eshte Arabishtja, Shqipja dhe Anglishtja. Cdo dokument ne njeren nga keto gjuhe eshte ligjor, neqoftese ka ndonje mosmareveshje, Arabishtja eshte baza.

#### **NENI 60 :**

Banka do te kete stemen dhe vulen e saj te aprovuar nga Keshilli i pare Drejtues.

#### **NENI 61 :**

Cdo aksioner lexoi me kujdes kete Statut dhe mori nje kopje te tij per te vepruar dhe proceduar ne baze te tij.



## BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

### NENI 62 : FIRMOSJA E STATUTIT

Statuti u firmos nga aksioneret ose nga mbajtesit e mandatit te caktuar prej tyre, pasi i eshte leshuar certifikata mbajtesve te fondeve.

### NENI 63 : AKSIONERET E BANKES

Aksioneret e bankes jane si me poshte :

EMRI	VENDI
1. Banka Kombetare Tregtare e Shqiperise	Shqiperi
2. Banka Arabe Islamike , Bahrein	Bahrein
3. Banka Islamike per Zhvillim	Arabia Saudite
4. Dallah Albaraka Holding Co.	Bahrein
5. Z. Hisham Ali Hafiz	Arabia Saudite
6. Z. Hamed H. Mutabagani	Arabia Saudite
7. Z. Solaiman A. El Khereiji	Arabia Saudite
8. Z. Adnan H. Bogary	Arabia Saudite
9. Z. Hayder Binladin	Arabia Saudite
10. Znj. Amal H. Bogary	Arabia Saudite
11. Brother Co.	Arabia Saudite
12. Z. Faisal A. El Khereiji	Arabia Saudite
13. Business Focus SDN BHD	Malaysia

---



# BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE

## KAPITULLI 11

### DISPOZITA LIGJORE

#### **NENI 64 :**

Banka e zhvillon aktivitetin e saj sipas parimit per menjanimin e rreziqeve ne kuadrin e urdher pagesave, rregulloreve dhe udhezimeve te Bankes se Shqiperise.

#### **NENI 65 :**

Duke kryer aktivitet bankar ligjor, banka ne radhe te pare, nuk mund te hyje ne transaksione industriale ose tregtare ose te kryeje sherbime, jo te caktuara per nje banke.

#### **NENI 66 :**

Administratoret, nepunesit dhe punonjesit e Bankes , sikurse dhe personat e ngarkuar me mbikqyrjen e aktivitetit te Bankes (edhe kur ata kane dhene doreheqjen nga posti i tyre) duhet te ruajne sekretin mbi informacionin qe ata kane marre gjate punes ne Banke dhe te mos t'a perdorin ate per perfitime vetijake ose t'ja japin personave te trete.

Ky lloj informacioni do te jete vetem per Banken e Shqiperise, duke perfshire mbikqyresit dhe kontrolloret e autorizuar, kontrolloret e jashtem ose autoritetet te tjera administrative dhe juridike, te cilet e kane kete te drejte me ligj. Megjithate kjo mund te behet kur synohet per te mbrojtur interesat e Bankes ne procedurat ligjore.





## **BANKA ARABE SHQIPTARE ISLAMIKE**

### **NENI 67 :**

Eshte e ndaluar per Banken qe te fshehe, konvertoje ose transferoje fonde kur ajo e di qe fonde te tilla jane si rezultat i nje aktiviteti kriminal, kur synohet te fshihet burimi jo ligjor i pasurise ose kur Banka synon te ndihmoje dike qe eshte perzjere ne nje aktivitet te tille qe shmang ligjin. Fakti qe Banka eshte mire informuar rreth burimeve te mesiperme duhet te provohet me dokumenta te vertetuara.

Me iniciativen e saj Banka duhet te informoje autoritetet pergjegjese per pastrimin e parave ose organet hetimore te aktivitetit kriminal dhe me kerkese te ketyre organeve t'i furnuzoje me informacionin perkates ne baze te ligjit.

### **NENI 68 :**

Banka duhet te paguaje te gjitha detyrimet dhe taksat e parashikuara me ligj.

### **NENI 69 :**

Persa i perket ndonje dispozite qe nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te zbatohet Ligji Nr.8075 "Mbi sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise", Ligji Nr. 7638 "Mbi Shoqerite Tregtare" si dhe Ligji Nr. 7632 "Mbi dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar".

